



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. 284/prot.
4

Tiranë, më 02.03.2026

URDHËR

Nr. 34, Datë 02.03.2026

PËR

**MIRATIMIN E PERIUDHËS SË APLIKIMEVE ME FORMULARIN A1/A1Z PËR
MATURËN SHTETËRORE 2026**

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”, i ndryshuar, të Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 661, datë 01.12.2023, “Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 27, datë 30.12.2025, “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2026”, si dhe Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 8, datë 13.03.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e periudhës së aplikimeve me formularin A1/A1Z, për MSH 2026, në datat 9-13 Mars 2026, ora 08.00 – 16.00.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrtat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida Myrto

